



Çfarë është RPU?

Rishikimi Periodik Universal (RPU) është një instrument specifik për monitorimin e situatës së të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB). RPU ofron një mundësi për të gjitha vendet që të ndajnë veprimet e ndërmarra për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut dhe për të kapërcyer sfidat në këtë fushë.



Kur u vendos?

RPU u vendos kur u krijua Këshilli i të Drejtave të Njeriut më 15 mars 2006 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 60/251.



Cili është qëllimi?

Qëllimi përfundimtar i RPU-së është përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut në çdo vend me pasoja të rëndësishme për njerëzit në mbarë botën. RPU është projektuar për të inkurajuar, mbështetur dhe për të shtrirë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në praktikë.



Sa shpesh është hartohet?

Situata e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara rishikohet çdo pesë vjet. Deri më tani, ka pasur tre cikle të RPU-së, dhe i katërti është aktualisht në realizim e sipër.



Kush e zbaton atë?

RPU zbatohet nga Grupi Punues i UNFPA-së, i cili përbëhet nga anëtarët e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, dhe secili shtet anëtar i OKB-së mund të marrë pjesë në diskutim me vendet në shqyrtim.



Cili është rezultati i RPU-së?

Grupi i punës, shteti i përfshirë dhe Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) hartojnë një raport, i cili është një përmbledhje e diskutimit dhe përbëhet nga pyetje, komente dhe rekomandime të bëra nga shtetet për vendin në shqyrtim, si dhe përgjigjet nga ai shtet.



Çfarë hapash ndërmerren pas RPU-së?

Shteti ka përgjegjësinë kryesore për të zbatuar rekomandimet e përfshira në raportin përfundimtar. Sipas RPU, të gjitha vendet janë përgjegjëse për progresin ose dështimin në zbatimin e këtyre rekomandimeve, dhe në shqyrtimin e ardhshëm, secili vend duhet të sigurojë informacion mbi aktivitetet e zbatuara për zbatimin e rekomandimeve.